VENDIM
Nr.748, datë 15.9.2010

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2010

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 16 të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e miratuar për vitin 2010 të bëhet rishpërndarja e fondeve, si më poshtë vijon:

a) Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, në programin buxhetor "Arsimi profesional", zëri "Shpenzime korrente", t'i zbritet fondi prej 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekësh.

b) Grupit "Institucione të tjera qeveritare", në programin buxhetor "Për shoqëritë e informacionit", zëri "Shpenzime korrente", t'i shtohet fondi prej 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekësh.

c) Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, në programin buxhetor "Arsimi profesional", zëri "Shpenzime kapitale", t'i shtohet fondi prej 35 000 000 (tridhjetë e pesë milionë) lekësh.

ç) Grupit "Institucione të tjera qeveritare", në programin buxhetor "Për shoqëritë e informacionit", zëri "Shpenzime kapitale", t'i pakësohet fondi prej 35 000 000 (tridhjetë e pesë milionë) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha